

**BASHKIA ELBASAN**

**RAPORT MONITORIMI  
BUXHETI 2024**

**4- MUJORI II-te (progresiv janar- gusht)**



**SHTATOR 2024**

Përmbajtja:

Buxheti i Bashkisë për vitin 2024, 4 Mujori i II-të ( periudha janar- gusht)

Realizimi i të ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2024, 4 Mujori i II-të ( periudha janar- gusht)

Realizimi i buxhetit për vitin 2024, 4 Mujori i II-të (periudha janar- gusht)

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkia Elbasan ushtron funksione të vetat dhe të deleguara, duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale.

F1. Funksioni “Shërbime të përgjithshme publike”

F2. Funksioni “Shërbime të huamarrjes vendore”

F3. Funksioni “Rendi dhe siguria publike”

F4. Funksioni “Çështje ekonomike”

F5. Funksioni “Mbrojtja e mjedisit”

F6. Funksioni “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”

F7. Funksioni “Argëtimi, kultura dhe feja”

F8. Funksioni “Arsimi”

F9. Funksioni “Mbrojtja Sociale”

## **I. BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2024 (4 mujori i II-të)**

Detajimi i buxhetit për 4 mujorin e dytë të vitit 2024 është hartuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, date 08.07. 2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017, datë 27.4.2017 “Pë financat e vetëqeverisjes vendore“, ligjin nr.97, datë 07.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024“ si dhe VKB nr. 126, datë 26.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkise Elbasan per vitin 2024, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2024-2026”, me ndryshime.

Programi Buxhetor i vitit 2024 parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore me qëllim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale; përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; mirëmbajtjen e tregjeve; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit; mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturës bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë; mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Zbatimi i Buxhetit të vitit 2024 është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës dhe mbrojtjen e mjedisit duke e kthyer Elbasanin në një qendër të përparuar social-ekonomike.

Ky dokument ka përcaktuar 9 programe dhe një seri funksionesh dhe aktiviteteve respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit që i mbështet këto projekte.

Bashkia Elbasan, administron dhe menaxhon fondet, sipas 9 programeve të miratuara, si më poshtë:

1. Programi “Menaxhimi dhe shërbimet mbështëtese”
2. Programi “Rendi dhe siguria publike”
3. Programi “Çeshtjet ekonomike dhe bujqësia”
4. Programi “Mbrojtja e mjedisit”
5. Programi “Zhvillimi urban dhe shërbimet publike”
6. Programi “Argëtimi, kultura dhe sportet”
7. Programi “Arsimi”
8. Programi “Mbrojtja civile”
9. Programi “Fondi rezervë dhe kontigjenca”

## **Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2024, vijnë nga dy drejtime:**

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione, dhe të ardhura të trashëguara.

**Nga burimet qëndrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja (sektoriale), transferuar Bashkisë.

Fondet e kushtëzuara të cilat vijnë nga buxheti i shtetit për financimin e funksioneve të deleguara si gjendja civile, ndihmat ekonomike, bursat etj. nuk janë objekt i monitorimit të buxhetit të Bashkisë, por në këtë material do të merrni informacion të përgjithshëm mbi përdorimin e fondeve.

## **II. REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR PERIUDHËN JANAR - GUSHT 2024**

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat të tjera dhe të ardhurat nga funksionet specifike, si shërbimi pyjor, ujëtja dhe kullimi, etj. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë periudhës janar- gusht 2024, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, Bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të Bashkisë.

Objektivat sipas programit të kryetarit të bashkisë, kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal, ndikuan në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave sa më pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet strukturave të bashkisë dhe agjentit tatimor Ujësjellës Kanalizime, të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, ndikuan në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Politikat për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqesore, etj. janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për rritjen e të ardhurave krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve të kaluara.

Këto politika të lehtësive fiskale kundrejt përmirësimit të shërbimit janë shoqëruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve..

## ➤ KATEGORIZIMI I TË ARDHUARAVE

Taksat vendore:

- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier
- Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
- Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5 milion deri në 8 milion,

Taksat e ndara:

- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë,
- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura,
- Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
- Të ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale

Tarifat vendore:

- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
- Tarifa për ndriçimin publik
- Tarifa për gjelbrimin
- Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Elbasan
  
- Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
- Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
- Tarifa për zënien e hapësirave publike
- Tarifa nga institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.

Të ardhura të tjera:

- Të ardhura nga gjoba
- Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e aseteve dhe e shërbimeve etj.


Të ardhura nga huaja:

➤ **Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë për periudhën janar-gusht 2024**

në mijë lekë

Nr.	Të ardhurat nga burimet e veta vendore	Plan 4 M II-të 2024 (janar-gusht)	Fakt 4 M II-të 2024 (janar-gusht)	Realizimi 4 Mujori II-të-në % (janar gusht)
1	Të ardhurat nga taksat (+ debitore )	481,338	274,622	57%
2	Të ardhura nga taksat e ndara	84,099	93,432	111%
3	Te ardhurat nga tarifat vendore (+debitore)	413,880	324,886	78%
4	Te ardhura te tjera	226,999	89,771	40%
5	Te ardhura nga donacionet (jasht limiti)	0	8,635	0%
	<b>TOTALI</b>	<b>1,206,316</b>	<b>791,346</b>	<b>66%</b>

## Te ardhura nga burimet e veta vendore




**Realizimi faktik i te ardhurave sipas muajve paraqitet si me poshte:**

në mijë lekë

MUAJI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT
TE ARDHURA	64,670	55,700	50,562	92,796	61,892	141,393	221,756	102,577

Paraqitja grafike:



Të ardhurat e veta u realizuan në proces dhe bashkëpunim me gjithë administratën e Bashkisë, me Njësitë Administrative, me institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj. Ndërsa periudha maj pati një ulje të nivelit të të ardhurave krahasuar me muajin prill, në muajt qershor dhe korrik, periudhë e cila përkon me afatet e pagesave, reflektohet tendencë në rritje.

➤ Realizimi i të ardhurave për periudhën Janar- Gusht 2024.

Nr	TE ARDHURA	PLAN VJETOR 2024	Plani Janar-Gusht 2024	Fakti Janar-Gusht 2024	Realizimi ne% 4 Mujori II-të 2024	Krahasimi ne % me planin Vjetor
	<b>TE ARDHURA</b>					
<b>A</b>	<b>TE ARDH.VENDORE (I+II+III+IV+V+VI+VII)</b>	<b>1,828,630</b>	<b>1,206,316</b>	<b>782,711</b>	<b>65%</b>	<b>43%</b>
<b>I</b>	<b>TE ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE</b>	<b>624,682</b>	<b>416,452</b>	<b>274,622</b>	<b>66%</b>	<b>44%</b>
1	Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV	2,000	1,334	876	66%	44%
2	Taksa mbi ndertesat	223,062	148,708	139,844	94%	63%
3	Taksa mbi token bujqesore	27,480	18,320	11,486	63%	42%
4	Taksa mbi truallin	36,840	24,560	21,884	89%	59%
5	Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	9,000	6,000	1,905	32%	21%
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	325,000	216,664	92,306	43%	28%
7	Taksa e tableles	1,300	866	6,321	730%	486%
<b>II</b>	<b>TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>	<b>126,150</b>	<b>84,099</b>	<b>93,432</b>	<b>111%</b>	<b>74%</b>
1	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise	6,500	4,333	10,448	241%	161%
2	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	78,750	52,500	58,617	112%	74%
3	Taksa e rentes minerare	900	600	303	51%	34%
4	Tatimi mbi te ardhurat personale	40,000	26,666	24,064	90%	60%
<b>III</b>	<b>TE ARDHURA NGA TARIFAT</b>	<b>538,209</b>	<b>358,762</b>	<b>324,886</b>	<b>91%</b>	<b>60%</b>
1	Tarife per zenien e hapesires publike	30,000	20,000	27,946	140%	93%
2	" pastrimi	186,250	124,160	147,195	119%	79%
3	" gjelberimi	39,000	26,000	33,866	130%	87%
4	" ndricimi	65,000	43,336	46,089	106%	71%
5	" mirembajtje infrastrukture ne Nj.Admin.	7,750	5,168	2,537	49%	33%
6	" reklame	6,000	4,000	4,272	107%	71%
7	" parkim automjete	37,500	25,000	10,500	42%	28%
8	" embleme bashkie	70	50	48	96%	69%
9	" leje, certificate transporti	3,000	2,000	1,236	62%	41%
10	" autorizim treg. karburanti + lende djegese	32,500	21,700	4,400	20%	14%
11	" leshimin e vertetimeve	2,284	1,522	777	51%	34%
12	" autoriz., zgjatje orari ,etj	2,200	1,466	1,598	109%	73%
13	" sherbimi karrotresh	500	333	18	5%	4%

14	" leje perdorimi per objekte biznesi	12,000	8,000	591	7%	5%
15	" leje perdorimi per banim	5,750	3,832	435	11%	8%
16	" certifikim relievi	2,300	1,534	627	41%	27%
17	" deklarim paraparak	1,500	1,000	430	43%	29%
18	" trajt.fasades ndertesave	2,000	1,334	818	61%	41%
19	" aplikim leje zhvillimi	1,000	666	140	21%	14%
20	" hartim PDV per siparf. e prones	13,750	9,166	3,719	41%	27%
21	" shqyrtim dokumenta leje ndert.	3,000	2,000	851	43%	28%
22	" kantier ndertimi brenda prones	5,500	3,666	3,225	88%	59%
23	" depozitimi i mbetjeve te ngurta	44,500	29,600	10,016	34%	23%
24	" leshimin e dok.nga arkiva	100	60	19	32%	19%
25	" rrjetin e tubacion.ujrave bardha	2,200	1,466	0	0%	0%
26	" rrjetin e tubacion.ujrave zeza	290	194	0	0%	0%
27	" sherbimi per rrjetin kabllor	4,000	2,666	3,277	123%	82%
28	" uji pijshem	15	10	2	20%	13%
29	" per mbrojtjen & permirs.mjedisit	28,250	18,833	20,254	108%	72%
<b>IV</b>	<b>TE ARDHURA JO-TATIMORE</b>	<b>188,870</b>	<b>116,244</b>	<b>29,803</b>	<b>26%</b>	<b>16%</b>
1	Qera objekti	560	372	456	123%	81%
2	Qera toke bujqesore	310	206	358	174%	115%
3	Gjoha ndertimi	70,000	46,666	2,100	5%	3%
4	Gjoha biznesi	9,000	6,000	8,185	136%	91%
5	Gjoha policia bashkiake	1,000	666	451	68%	45%
6	Te ardhura nga legalizimet	50,000	33,334	3,679	11%	7%
7	Te ardhura nga shitja e asetëve (FK)	58,000	29,000	14,127	49%	24%
8	Qera Trualli			112		
9	Te ardhura nga shitja ndertime			0		
10	Sekuestrime dhe zhdemtime			335		
<b>V</b>	<b>TE ARDHURA INSTITUCIONET</b>	<b>79,730</b>	<b>50,073</b>	<b>36,791.00</b>	<b>73%</b>	<b>46%</b>
1	<b>Qendra Ekonomike Arsimit</b>	<b>55,254</b>	<b>33,696</b>	<b>22,365.00</b>	<b>66%</b>	<b>40%</b>
	Te ardhura nga Cerdhet	12,003	7,200	5,128	71%	43%
	Te ardhura nga kopeshtet	35,042	21,024	12,114	58%	35%
	Te ardhura nga qerate	8,209	5,472	5,123	94%	62%
2	<b>Te ardhura Klubi Shumesporte</b>	<b>1,246</b>	<b>830</b>	<b>842.00</b>	<b>101%</b>	<b>68%</b>
	Te ardhura nga qira objekti	1,246	830	842	101%	68%
3	<b>Qendra e Artit</b>	<b>750</b>	<b>490</b>	<b>703.00</b>	<b>143%</b>	<b>94%</b>
	Te ardhura nga biletat	600	400	583	146%	97%
	Te ardhura okupim salle	150	90	120	133%	80%
4	<b>Agjencia e Kultures dhe Turizmit</b>	<b>230</b>	<b>150</b>	<b>205.00</b>	<b>137%</b>	<b>89%</b>
	Te ardhura Trashegimia Kulturore	230	150	205	137%	89%
	Te ardhura Biblioteka	0				

<b>5</b>	<b>Agjensia e Sherbimeve Publike Urbane</b>	<b>14,250</b>	<b>9,575</b>	<b>7,377.00</b>	<b>77%</b>	<b>52%</b>
	Te ardhura sherbimet publike	250	175	3	2%	1%
	Te ardhura M.Varreza	11,000	7,400	7,049	95%	64%
	Tarife sherbimi per subjektet qe kryejne punime per riparimin e varreve	3,000	2,000	325	16%	11%
<b>6</b>	<b>Te ardhura nga Banesat Sociale me Qira</b>	<b>8,000</b>	<b>5,332</b>	<b>5,299.00</b>	<b>99%</b>	<b>66%</b>
	Te ardhura nga qirate	8,000	5,332	5,299	99%	66%
<b>VI</b>	<b>TE ARDHURA FUNKSIONET SPECIFIKE</b>	<b>90,989</b>	<b>60,682</b>	<b>23,177</b>	<b>38%</b>	<b>25%</b>
<b>1</b>	Te ardhura nga Zjarrfikesja	2,000	1,334	742	56%	37%
<b>2</b>	Te ardhura Ujitja dhe Kullimi	6,000	4,000	5,034	126%	84%
<b>3</b>	<b>Te ardhura nga Sherbimi Pyjor</b>	<b>82,989</b>	<b>55,348</b>	<b>17,401</b>	<b>31%</b>	<b>21%</b>
	Te ardhura nga vertetime, etj.	700	468	152	32%	22%
	Tarife per lende drusore	47,973	32,000	4,614	14%	10%
	Qera per pyje dhe kullota	34,316	22,880	12,635	55%	37%
<b>VII</b>	<b>ARKETIM DEBITORESH</b>	<b>180,000</b>	<b>120,004</b>			
<b>1</b>	Arketimi i detyrimeve prapamb.(familje UKE)	102,500	68,340			
<b>2</b>	Debitore te mbartur ne vite (taksa-tarifa)	77,500	51,664			
<b>B</b>	<b>Te ardhura Jashte Limiti</b>			<b>8,635</b>		
<b>1</b>	Grant nga keshilli i qarkut			8,530		
<b>2</b>	Takse pulle gjendja civile	0		97		
<b>3</b>	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin (1 %)			8		
	<b>Totali te ardhurave</b>	<b>1,828,630</b>	<b>1,206,316</b>	<b>791,346</b>	<b>66%</b>	<b>43%</b>

Ne tabelën e mësipërme vërehet se të ardhurat vendore, për 4 mujorin e dytë të vitit 2024 (periudha janar- gusht), janë realizuar në masën **66% si tetëmuor**, ose në vlerë totale **791,346** mijë lekë.

Nga këto, të ardhurat nga taksat vendore (përfshirë debitorët në vite), janë realizuar në masën **57%**, ose në vlerë totale **274,622** mijë lekë.

Nga këto, të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar në masën **111%**, ose në vlerë totale **93,432** mijë lekë.

Nga këto, të ardhurat nga tarifatat (përfshirë debitorët në vite), janë realizuar në masën **78%** ose në vlerë totale **324,886** mijë lekë.

Nga këto të ardhurat e tjera janë realizuar në masën **40%** ose në vlerë totale **89,771** mijë lekë.

Nga këto, të ardhurat nga donacionet, janë realizuar në vlerë totale **8,635** në mijë lekë.

Në total, plani i të ardhurave për periudhën janar- gusht 2024 është realizuar në masën **66%**.

*Në planin e të ardhurave, miratuar në buxhetin e vitit 2024, janë planifikuar “Arkëtim debitorë”, për shumën 180,000 mijë lekë, i ndarë 102,500 mijë lekë detyrime të prapambetura nga familjarët (UKE) dhe 77,500 mijë lekë nga subjektet.*


*Gjithashtu, këto detyrime janë shpërndarë në tabelën e mësipërme, plan dhe fakt, vjetor dhe tetëmujor, sipas zërave të taksave dhe tarifave.*

- **Të ardhurat e përgjithshme në total, nga burimet e veta vendore dhe burimet qëndrore për vitin 2024.**

**Në mijë lekë**

<b>Të ardhurat e përgjithshme në total, nga burimet e veta vendore dhe burimet qëndrore për vitin 2024 (vjetor)</b>		
<b>1</b>	Të ardhura nga taksat dhe tarifave vendore	782,710
<b>2</b>	Të ardhura nga donacione	8,635
<b>3</b>	Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar	1,009,975
<b>4</b>	Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike)	534,053
<b>5</b>	Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar	1,756,920
<b>6</b>	Të ardhura të trashëguara nga viti 2023 (të ardh. veta + grante)	381,513
<b>7</b>	Huamarrja	0
<b>TOTALI</b>		<b>4,473,806</b>

Paraqitje grafike



**1. Të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore** janë realizuar **782,710** mijë lekë, ose **17%** e të ardhurave të përgjithshme.

**2. Të ardhura nga donacione** janë realizuar **8,635** mijë lekë.

**3. Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar** janë realizuar **1,009,975** mijë lekë, ose **23 %** e të ardhurave të përgjithshme.

**4. Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike)** janë realizuar **534,053** mijë lekë, ose **12 %** e të ardhurave të përgjithshme.

**5. Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar** janë realizuar **1,756,920** mijë lekë, ose **39 %** e të ardhurave të përgjithshme.

**6. Të ardhura të trashëguara nga viti 2023** janë realizuar **381,513** mijë lekë, ose **9%** të ardhurave të përgjithshme.

### III. REALIZIMI I BUXHETIT VITI 2024, KATER MUJORI I DYTE

Realizimi i buxhetit të vitit 2024 është bërë duke respektuar ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, ligjin nr.97, datë 07.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024“ si dhe VKB nr. 126, datë 26.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkise Elbasan per vitin 2024, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2024-2026”.


Shpenzimet e buxhetit sipas programeve buxhetore, për periudhën janar-gusht 2024, me burim financimi (transfera e pa kushtezuar, transfera e pakushtezuar sektoriale, të ardhurat nga taksat dhe tarifatat dhe të ardhura jashtë limiti), arritën në **1,621,726**, me një nivel realizimi prej **42%**.

PROGRAMI	EMERTIMI	PLAN VJETOR 2024	FAKTI Janar-Gusht 2024	REALIZIMI
AA109	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	619,377	343,556	55%
AB109	Rendi dhe Siguria Publike	202,849	51,197	25%
AC109	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	826,424	233,243	28%
AD109	Mbrojtja e Mjedisit	347,531	175,777	51%
AE109	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	475,933	257,710	54%
AF109	Argëtimi , Kultura dhe Sportet	268,197	133,064	50%
AG109	Arsimi	903,846	345,424	38%
AH109	Mbrojtja Civile	173,330	81,755	47%
AI109	Fondi Rezervë dhe Kontigjenca	29,000	0	0%
	<b>TOTALI</b>	<b>3,846,487</b>	<b>1,621,726</b>	<b>42%</b>

Të dhënat ekonomike:

EMERTIMI	PLAN VJETOR 2024	FAKTI JANAR-GUSHT 2024	REALIZIMI
<b>Paga+Sigurime(600+601)</b>	1,437,481	851,075	59%
<b>Shpenzime operative (602+651+166)</b>	1,122,065	516,327	46%
<b>Transferta ( 604+605+606+609)</b>	202,892	18,878	9%
<b>Investime (230+231)</b>	1,084,049	235,446	22%
<b>Totali</b>	<b>3,846,487</b>	<b>1,621,726</b>	<b>42%</b>

Paraqitja grafike:



Bazuar në shpenzimet faktike të 4 mujorit te dyte të vitit 2024 :

Peshën më të madhe të realizimit në përqindje e zënë shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime), të cilat janë realizuar në masën **59%**, ku përveç pagave të administratës bëjnë pjesë edhe pagat e punonjësve të arsimit parashkollor (edukatorët e kopështeve), punonjësit e konvikteve, punonjësit mbështetës të arsimit parashkollor dhe të mesëm, shërbimi zjarrfikës, ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave etj, sipas funksioneve të cilat iu deleguan bashkive pas reformës territoriale.

Një zë i rëndësishëm janë shpenzimet operative, te cilat janë realizuar në masën **46%** të planit, financiar këto nga transferta e pakushtëzuar, transferta sektoriale, të ardhurat tona dhe të ardhurat jashtë limiti.

**Shpenzimet për paga** zënë **52%** të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar me burim financimi **47%** transfertën e pakushtëzuar dhe **15%** të ardhurat e veta, **37%** me transfertë specifike

**Shpenzimet operative** zënë **32%** të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar **45%** me burim financimi transfertën e pakushtëzuar **7%** transferten sektoriale, **48%** të ardhurat e veta dhe **1%** jashte limiti.

**Shpenzimet për transferime** zënë **1%** të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar **78%** me transfertë të pakushtëzuar, **1 %** transferten sektoriale dhe **22%** të ardhurat e veta.

**Shpenzimet për investime** zënë **15%** të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar **27%** me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe **71%** nga të ardhurat e veta dhe **1%** jashte limiti.



Realizimi i shpenzimeve për 4 Mujorin e II-te 2024, (Grant+G.Specifik+te Ardhura+J.Limiti)											në mijë lekë	
Programi	kod/Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ bvencione		Shpenzime Kapitale		Total buxheti		
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA109	372,860	223,599	170,483	89,738	111,418	2,298	46,160	27,921	619,377	343,556
2	Rendi dhe Siguria Publike	AB109	70,722	45,555	11,585	3,118	107,638	2,427	12,904	97	202,849	51,197
3	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	AC109	124,791	69,222	115,728	31,547	7,120	120	578,785	132,354	826,424	233,243
4	Mbrojtja e Mjedisit	AD109	31,170	18,577	290,270	137,200	-	-	26,091	20,000	347,531	175,777
5	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	AE109	153,130	90,885	262,046	146,214	430	424	60,327	20,187	475,933	257,710
6	Argëtimi, Kultura, Sportet	AF109	116,220	67,695	87,992	48,982	3,400	1,550	60,585	14,837	268,197	133,064
7	Arsimi	AG109	484,862	281,705	144,618	43,196	1,795	1,157	272,571	19,366	903,846	345,424
8	Mbrojtja Civile	AH109	83,726	53,837	39,343	16,332	23,635	10,902	26,626	684	173,330	81,755
9	Fondi rezerve & Kontigjenca	AI109	-	-	-	-	29,000	-	-	-	29,000	-
<b>TOTALI</b>			<b>1,437,481</b>	<b>851,075</b>	<b>1,040,521</b>	<b>516,327</b>	<b>284,436</b>	<b>18,878</b>	<b>1,084,049</b>	<b>235,446</b>	<b>3,846,487</b>	<b>1,621,726</b>

Realizimi i shpenzimeve për 4 Mujorin e II-te 2024 (Transferte e Pakushtezuar + Te ardhura)											ne mije leke	
Programi	kod/ Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ subvencione		Shpenzime Kapitale		Total buxheti		
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA109	372,860	223,599	169,538	89,643	27,480	2,289	43,175	24,964	615,439	340,495
2	Rendi dhe Siguria Publike	AB109	35,800	20,683	5,031	1,920	105,241	2,427	3,590	-	149,662	25,030
3	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	AC109	86,658	40,633	94,844	20,530	7,120	120	574,085	131,454	762,707	192,737
4	Mbrojtja e Mjedisit	AD109	31,170	18,577	272,007	122,955	-	-	26,091	20,000	329,268	161,532
5	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	AE109	153,130	90,885	262,046	146,214	430	424	53,797	20,187	469,403	257,710
6	Argëtimi, Kultura, Sportet	AF109	116,220	67,695	85,492	46,482	3,400	1,550	60,585	14,837	265,697	130,564
7	Arsimi	AG109	46,630	30,495	132,724	40,146	1,650	1,012	216,004	19,366	397,008	91,019
8	Mbrojtja Civile	AH109	67,094	40,584	33,343	11,932	23,635	10,902	26,626	684	150,698	64,102
9	Fondi rezerve & Kontigjenca	AI109	-	-	-	-	29,000	-	-	-	29,000	-
<b>TOTALI</b>			<b>909,562</b>	<b>533,151</b>	<b>973,481</b>	<b>479,822</b>	<b>281,886</b>	<b>18,724</b>	<b>1,003,953</b>	<b>231,492</b>	<b>3,168,882</b>	<b>1,263,189</b>

Realizimi i shpenzimeve Nga Transferta Sektoriale per 4 Mujorin e II-te 2024,											në mijë lekë	
Programi	kod/Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ bvencione		Shpenzime Kapitale		Total buxheti		
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA109	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Rendi dhe Siguria Publike	AB109	34,922	24,872	6,554	1,198	-	-	9,314	97	50,790	26,167
3	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	AC109	38,133	28,589	20,884	11,017		-	4,700	900	63,717	40,506
4	Mbrojtja e Mjedisit	AD109	-	-	18,263	14,245					18,263	14,245
5	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	AE109	-	-	-	-	-	-	-	-		-
6	Argëtimi, Kultura, Sportet	AF109	-	-	-	-		-		-		-
7	Arsimi	AG109	438,232	251,210	11,894	3,050	145	145	43,500	-	493,771	254,405
8	Mbrojtja Civile	AH109	16,632	13,253	6,000	4,400		-		-	22,632	17,653
9	Fondi rezerve & Kontigjenca	AI109	-									-
<b>TOTALI</b>			<b>527,919</b>	<b>317,924</b>	<b>63,595</b>	<b>33,910</b>	<b>145</b>	<b>145</b>	<b>57,514</b>	<b>997</b>	<b>649,173</b>	<b>352,976</b>

Realizimi i shpenzimeve Nga Transferta e Pakushtezuar per 4 Mujorin e II-te2024,											në mijë lekë	
Programi	kod/ Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ bvencione		Shpenzime Kapitale		Total buxheti		
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA109	194,587	127,153	49,649	55,886	34,239	2,239	18,665	17,332	297,140	202,610
2	Rendi dhe Siguria Publike	AB109	17,470	13,479	4,160	1,920	30	30		-	21,660	15,429
3	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	AC109	55,613	36,570	14,117	7,408	120	120	67,234	33,652	137,084	77,750
4	Mbrojtja e Mjedisit	AD109	25,950	18,577	52,131	34,744	-	-	320	-	78,401	53,321
5	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	AE109	103,940	68,153	105,384	74,160	310	304	8,564	823	218,198	143,440
6	Argëtimi, Kultura, Sportet	AF109	98,180	67,695	42,823	30,293	100	50	9,215	648	150,318	98,686
7	Arsimi	AG109	39,720	30,495	43,147	22,123	1,650	1,012	29,314	10,859	113,831	64,489
8	Mbrojtja Civile	AH109	57,884	40,584	10,679	4,562	17,595	10,902	1,660	684	87,818	56,732
9	Fondi rezerve & Kontigjenca	AI109									-	-
<b>TOTALI</b>			<b>593,344</b>	<b>402,706</b>	<b>322,090</b>	<b>231,096</b>	<b>54,044</b>	<b>14,657</b>	<b>134,972</b>	<b>63,998</b>	<b>1,104,450</b>	<b>712,457</b>

Shpenzime nga te Ardhurat Jashte Limiti për 4 Mujorin e II-te 2024												ne mije leke	
Nr	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta		Shpenzime Kapitale		Total buxheti		
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA109			945	95	8	8	2,985	2,957	3,938	3,060	
2	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	AE109							6,530		6,530	-	
3	Argëtimi, Kultura, Sportet	AF109			2,500	2,500					2,500	2,500	
4	Arsimi	AG109							4,030		4,030	-	
<b>TOTALI</b>					<b>3,445</b>	<b>2,595</b>	<b>8</b>	<b>8</b>		<b>2,957</b>	<b>16,998</b>	<b>5,560</b>	

**A) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta vendore.**

Këto burime të ardhurash zënë një vënd kryesor në buxhetin e bashkisë pasi financojnë pothuajse të gjitha funksionet në administrim të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara nga ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe përbëjnë 51% të totalit të buxhetit.

Gjatë 4 mujorit te dyte te vitit 2024 (janar- gusht), përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi në mënyre racionale burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e funksioneve bazike dhe veçanërisht atyre sociale.


**Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik:**

<b>Emertimi</b>	<b>PLAN VJETOR 2024</b>	<b>FAKTI 4 MUJOR I DYTE 2024 (janar- gusht)</b>	<b>REALIZIMI %</b>
<b>Paga dhe Sigurime</b>	909,562	533,151	59%
<b>Shpenz.Operative</b>	1,055,025	479,822	45%
<b>Transferime</b>	200,292	18,724	9%
<b>Investime</b>	1,003,953	231,492	23%
<b>TOTALI</b>	<b>3,168,832</b>	<b>1,263,189</b>	<b>40%</b>

Totali i shpenzimeve buxhetore të realizuara me burimet e veta, krahasuar me planin vjetor është **40%**, ose ne vlerë **1,263,189** mijë lekë.

- Pagat janë realizuar në masën **59%**, ose në vlerë **533,151** mijë lekë;
- Shpenzimet operative janë realizuar në masën **45%**, ose në vlerë **479,822** mijë lekë;
- Transferimet janë realizuar në masën **9%** ose në vlerë **18,724** mijë lekë;
- Dhe investimet janë realizuar në masën **23%**, ose në vlerë **231,492** mijë lekë.

Paraqitja grafike:



**Fondi rezerve** në buxhetin e vitit **2024** është planifikuar në shumën **13,000 mijë lekë**, ndërsa fondi i kontigjencës **16,000 mijë lekë**.

Gjatë periudhës Janar- Gusht 2024 të vitit 2024 fondi rezerve dhe fondi i kontigjences nuk janë përdorur.


**Fondi i emergjencave civile**, gjatë periudhës Janar- Gusht 2024 është përdorur me vendim të Këshillit Bashkiak në pese raste, me vlerë totale **5,143,798 lekë**, konkretisht :

1. V.K.B nr.16, datë 23.02.2024, me vlerë **110,857** lekë, konfirmuar nga Prefektura me aktin nr.293/1, datë 01.03.2024.
2. V.K.B, nr .17, datë 23.02.2024, me vlerë **948,010 lekë**, konfirmuar nga Prefektura me aktin nr .294/1, datë 01.03.2024.
3. V.K.B nr.15, datë 23.02.2024, me vlerë **1,338,031** lekë, konfirmuar nga Prefektura me aktin nr.292/1, datë 01.03.2024.
4. V.K.B nr.52, datë 31.05.2024, me vlerë **460,000** lekë, konfirmuar nga Prefektura me aktin nr.639/3, datë 08.07.2024.
5. V.K.B nr.80, datë 30.07.2024, me vlerë **2,286,900** leke, konfirmuar nga Prefektura me aktin nr.837/1, datë 13.08.2024

### **Investimet nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar:**

Sipas detajimit të buxhetit dhe depozitimit në sistemin e Thesarit, janë planifikuar **88,637 mijë lekë** nga transferta e pakushtëzuar, **9,500 mije lekë** nga transferta sektoriale (specifike), **192,371 mijë lekë** nga fondet e trashëguara nga viti 2023, nga të ardhurat e vitit 2024 janë **696,218 mijë lekë** dhe të ardhura nga huaja **83,778 mijë lekë**, gjithsej **1,070,504 mijë lekë**.

Paraqitja grafike:



Rreth **65%** e investimeve financohen nga të ardhurat e vitit, duke bërë që prokurimi dhe realizimi i tyre të varet shumë nga arkëtimi dhe realizimi i planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Rreth **8%** të investimeve financohen me transfertë të pakushtëzuar, **1%** të investimeve financohen me transfertë sektoriale dhe **8%** e investimeve financohen me të ardhura nga huaja dhe nga fondet e trashëguara financohen **18 %** e investimeve.

Investimet (shpronësimet) nga huaja nuk janë realizuar për mungesë të dokumentacionit për shpronësim dhe proceseve gjyqesore mes trashëgimtarëve.

#### **B) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale**

Në vitin 2024 Bashkia vazhdon të kryejë funksionet e transferuara me burim financimi transfertën sektoriale (specifike). Funksionet që u transferuan në Bashki janë:

**i. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.**

Në transfertën specifike të 4 mujorit te pare te vitit 2024, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Për arsimin parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjës në qendrën kulturore të fëmijëve), janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 252 punonjës të transferuar. Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (parashkollor dhe Qendra kulturore e fëmijëve) dhe mesem përgjithshem janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 172 punonjës të transferuar.

**i. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)**

Në transfertën specifike të 4 mujorit te pare te vitit 2024, janë alokuar fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond bëjnë pjesë shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Numri i punonjësve është 35. Bashkia ka financuar nga të ardhurat e veta te SHMZSH për blerje kondicioner, stufë ngrohje me dru, për shumën 230 mijë lekë.

**ii. Administrimi i pyjeve**

Në transfertën specifike të 4 mujorit te pare te vitit 2024, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond përfshihen shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2024 numri i punonjësve është 26.

Bashkia Elbasan në strukturën organizative të saj, ka krijuar Agjensinë e Pyjeve, Bujqësisë, dhe Mjedisit, në të cilën bën pjesë Drejtoria e pyjeve, e cili merret me administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Gjithashtu, meqënëse fondet nga transfertat sektoriale janë të pamjaftueshme për këtë shërbim, Bashkia Elbasan ka financuar nga të ardhurat e veta në zërin paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime, për të siguruar mbarëvajtjen e këtij shërbimi.

**iii. Rrugët rurale**

Në transfertën specifike të 4 mujorit te pare te vitit 2024, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Fondet e alokuara nga kjo transfertë janë të pamjaftueshme për të financuar të gjithë zërat e shpenzimeve të domosdoshëm për këtë funksion. Në këto kushte Bashkia Elbasan ka financuar nga të ardhurat e veta në zërin paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime, për të siguruar mbarëvajtjen e këtij shërbimi.

#### iv. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të 4 mujorit te pare te vitit 2024, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond perfshihen fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2024 numri i punonjësve është 25. Ky shërbim është i atashuar në Agjensinë e Shërbimeve Publike Rurale, Sektori i Kullimit dhe Vaditjes. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka Ujitja dhe Kullimi, Bashkia Elbasan ka financuar nga fondet e veta si në shpenzime personeli, nëpërmjet punëtorëve sezonale, ashtu dhe në investime, për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tokës.

#### v. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën specifike të 4 mujorit te pare te vitit 2024, Bashkisë Elbasan i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë janë të përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzime operative dhe shpenzime për investime.

#### vi. Qendrat e Shërbimeve Sociale


Në transfertën specifike të 4 mujorit te pare te vitit 2024, për Bashkinë Elbasan janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative për Qendrën Sociale “Balashe” Elbasan. Edhe në këtë rast Bashkia Elbasan ka financuar nga fondet e veta në shpenzime personeli, operative dhe investime.

Gjithashtu në këtë qendër kryejnë aktivitetin e tyre “Qendra Rome” dhe “Shtëpia e të Moshuarve”, të cilat Bashkia Elbasan i financon nga fondet e veta.

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën sektoriale, në krahasim me planin vjetor rezulton të jetë **54%**. Pagat janë realizuar me **60%**, shpenzimet operative me **53%**, transferta me **100%** dhe investime me **2%**.

			000/lekë
Emertimi	PLANI VJETOR 2024	FAKTI JANAR-GUSHT 2024	Realizimi %
Paga dhe Sigurime	527,919	317,924	60%
Shpenz. Operative	63,595	33,910	53%
Transferime	145	145	100%
Investime	57,514	997	2%
<b>TOTALI</b>	<b>649,173</b>	<b>352,976</b>	<b>54%</b>

Paraqitja grafike:



### C) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e kushtëzuar

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe, realizimi i shpenzimeve për 4 mujorin e dytë të 2024 si më poshtë:

**1.1,274,536 mije leke** ose **99%** janë përdorur për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe,

**2.15,120 mije leke** ose **1%** janë përdorur për gjendjen civile.


EMERTIMI	PLANI 2024	FAKTI janar-gusht 2024
Gjendja Civile	25,426	15,120
Trajtim ushqimor (bursat e nxenesve)	56,325	44,999
Bonus trehimi	20,898	16,296
Invaliditet+Paaftesia+Nd.Ekonomike	1,546,418	1,199,776
Projekte të mbrojtjes sociale	1,716	757

<b>Emergjencat civile</b>	30,978	6,551
<b>Permiresim i infrastruktures kryesisht ne zona informale qe jane ne proces legalizimi ne zona banimi me mungese sherbimesh si ujesjelles,kanalizime etj...( Rikonstrukcion i gjendjes ekzistuese te rruges " Arif Dardha), bashkfinanc.ministria ekonomise)</b>	6,157	6,157
<b>Pajisje mobilerie per shkollat e arsimit i mesem pergjithshem( Konstandin kristoforidhi),Shkolla "Onufri" dhe Shkolla " Hamit Mullisi" )</b>	14,841	0
<b>Ndertim i shkolles " Jonuz Sali Çarçiu "</b>	40,620	0
<b>Mbrojtja e lagjes se Noneve nga gerryerja e perroit te Gostimes, fshati Polis Vale, Nj. Adm.shushice</b>	13,541	0
<b>TOTALI</b>	<b>1,756,920</b>	<b>1,289,656</b>

#### Të dhënat ekonomike:

			000/lekë
<b>Emertimi</b>	<b>PLANI VJETOR 2024</b>	<b>FAKTI JANAR-GUSHT2024</b>	<b>Realizimi %</b>
<b>Paga dhe Sigurime</b>	25,426	15,120	59%
<b>Shpenz.Operative</b>	18,411	9,628	52%
<b>Transferime</b>	1,637,724	1,258,751	77%
<b>Investime</b>	75,159	6,157	8%
<b>TOTALI</b>	<b>1,756,920</b>	<b>1,289,656</b>	<b>73%</b>

#### Paraqitja Grafike:



Në totalin e shpenzimeve, me burim financimi transfertën e kushtëzuar, realizimi për vitin 4 mujorin e dyte te vitit 2024, krahasuar me planin vjetor është **73%** ose **1,289,656** mijë lekë. Shpenzimet për paga janë realizuar në masën **59%** dhe transferimet ku bëjnë pjesë paaftësia dhe ndihma ekonomike në masën **77%** dhe investimet janë realizuar në masën **8%**.

#### **D) Shpenzime (investime) me të ardhurat nga huaja.**

Një zë të vecantë në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të Bashkisë Elbasan zë huaja për shpronësime dhe investime në infrastrukturën rrugore, bazuar në marrëveshjen datë 29.09.2010, marrëveshjen e interceptimit nr.2544/1, datë 29.09.2010 dhe në aneks-marrëveshjen nr.751/1, datë 26.05.2014, lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe BKT.

Shuma totale e huasë së miratuar, pas rishikimit, sipas aneks –marrëveshjes, është 711 milion lekë.

Shuma e disbursuar gjithsej është 627 milione lekë, e cila është përdorur për shpronësime dhe pjesërisht për investime në infrastrukturën rrugore. Mbeten për disbursim 84 milion lekë, të cilat janë pjesë e buxhetit të miratuar për vitin 2024.

Nga shuma e huasë së disbursuar Bashkia Elbasan ka shlyer rregullisht këstet e shërbimit të borxhit (principal +interes), çdo muaj, bazuar në planin e pagesave të bankës.

Të dhëna mbi haumarrjen e Bashkisë Elbasan.

Në mijë lekë

	Shuma	Sherbimi i borxhit te paguar deri me 31.08.2024			Sherbimi i borxhit per tu paguar deri ne maturim		
		principal	interesa	<b>gjithsej</b>	principal	interesa	<b>gjithsej</b>
<b>Hua e disbursuar</b>	627,410	594,012	206,943	<b>800,955</b>	33,398	3,204	<b>36,602</b>
<b>Hua pa disbursuar</b>	84,197						
<b>Gjithsej :</b>	<b>711,607</b>						

## E) Programet kryesore në zërat e buxhetit.

### i. Programi Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse

Programi i administratës vendore përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e tjera të punës, veçanërisht në vazhdimësinë e zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në të gjitha nivelet e institucionit për të mundësuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrit ligjor në funksion.

Qeverisja jonë lokale bazohet në parimet e sundimit të ligjit, përgjegjësisë, llogaridhënies, besimit, transparencës, efektivitetit, efikasitetit, partneritetit dhe koherencës.

Meqënëse qeverisja e mirë ndërlidhet me aftësinë e Bashkisë për të siguruar shërbimin më të mirë për komunitetin, çdo anëtar është aktiv për të dhënë kontributin e tij. Prandaj, për ne ekziston një nevojë e vazhdueshme që Bashkia të veprojë si lehtësuese duke iu prirë qytetarëve:

drejt të menduarit strategjik,  
duke i përfshirë ata në çështjet e pushtetit lokal,  
duke i bërë partnerë në zgjidhjen e problemeve.

Politikat e vazhdueshme, të cilat do të zbatohen nga administrata e Bashkisë Elbasan, janë :

1. Një strukturë menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për përthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë Elbasan, për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
2. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.
3. Dixhitalizmi i administratës publike është dhe do të mbetet një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore.

Ne jemi të angazhuar për të shtuar dhe promovuar shërbimet elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore. Është realizuar ofrimi i shërbimeve administrative elektronike ndaj qytetarëve në Bashkinë Qendër dhe në Njësitë Administrative.

## **ii. Çeshtjet ekonomike dhe bujqësia**

### **Politikat e zhvillimit**

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses më të mirë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare. Programi i infrastrukturës rrugore, bazohet në 2 politika themelore:

1. Përmirësimin e mjedisit urban me standartet e duhura në shërbim të komunitetit.
2. Rritjen e cilësisë dhe sigurisë së jetës së banorëve.

Objektivat kryesorë të këtij programi janë:

1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;
2. Përmirësim i infrastrukturës rrugore si dhe të rritje e aksesit ndaj shërbimeve bazë në zonat rurale.
3. Përmirësim i sigurisë në rrugët e Bashkisë së Elbasanit.
4. Mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të Bashkisë.
5. Reduktim i kostove për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknologjike dhe përdorimit të fuqisë punëtore të njërive administrative.

Pyjet kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet sigurimit të mirëqenies njerëzore, sigurojnë një mjedis të shëndetshëm dhe mbështesin zhvillimin ekonomik të zonës në tërësi. Potenciali unik i pyjeve mbështet një ekonomi të gjelbër, rrit cilësinë e jetës dhe ndikon në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Sfida për të realizuar këtë balancë të qëndrueshme mjedisore është e madhe dhe e vështirë referuar edhe larmshmërisë së territorit dhe problematikave që mbart secili sistem territorial.

Në buxhetin e këtij viti janë miratuar fonde për investime në shërbimin pyjor, për shtimin e sipërfaqeve të pyllëzuara, nga të cilat përmëndim:

- Hartim plane mbarështimi pyje e kullota;
- Investime në fondin pyjor (pyllëzime, përmirësime);
- Blerje aparate dixhitale, drone profesionale për monitorimin e pyjeve;
- Vendosje sinjalistike për shtigje malore dhe stola pushimi në zona pyjore

Në buxhetin e vitit 2024, shpenzimet për investime në programin **AC109** Çeshtjet ekonomike dhe bujqësia zënë peshën më të madhe të totalit të buxhetit për investime, me rreth **53 %**, ose **578,785** mijë lekë. Ndërsa investimet për programin **AG109** Arsimi, ku përfshihen arsimi bazë, mesëm përgjithshëm zënë **25%** të totalit të buxhetit për investime ose **272,571** mijë lekë.

### **iii. Mbrojtja e mjedisit / Zhvillimi urban dhe shërbimet publike**

Programet e ofrimit të shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrative të Bashkisë përbëjnë një nga kolonat kryesore të programit buxhetor.

Keto programe përmbajnë shërbimet më jetike për komunitetin siç janë:

- a) mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane,
- b) mirëmbajtja dhe administrimi i sipërfaqeve të gjelberta,
- c) mirëmbajtja e varrezave publike dhe krijimi i kushteve sipas standartave për shërbimin funeral,
- d) shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike,
- e) mobiliteti dhe transporti nëpërmjet krijimit të lehtësirave të lëvizjes, krijimin e kushteve për transportin publik,
- f) frealizimi sipas standarteve të sinjalistikës rrugore.

Shërbimet publike, për nga rëndësia e tyre, ndikojnë direkt në cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe janë një parakusht për zhvillimin social ekonomik për të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Programet e shërbimeve publike, bazohen në tre politika themelore :

1. Ofrimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.
2. Rritja e efiçensës të teknologjisë si dhe zgjerimit të shërbimit nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm
3. Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe të monitorimit, për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre.

### **Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane**

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, menaxhimi i mbetjeve të ngurta duke sunuar drejt ndarjes në burim të atyre të riciklueshme nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor që bën të mundur përmirësimin e situatës mjedisore dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill. Në buxhetin e vitit 2024 ka një rritje të shpenzimeve për shërbimin e pastrimit, krahasuar me periudhat praardhëse, duke shtuar zonat e mbuluara me këtë shërbim por edhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimit të ofruar. Gjithashtu është parashikuar që kontrata e shërbimit të pastrimit të mbulohet 100 % me të ardhurat nga tarifa e pastrimit.

### **Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike**

Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor në të gjithë Bashkinë.

### **Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit**

Synohet për një shërbim cilësor me standarte sipas normativave dhe rregullores së mirëmbajtjes së varrezave nëpërmjet hartimit të një plani të integruar për funksionimin e Varrezave Publike. Gjithashtu synohet zgjerim i territorit të Varrezave Publike për vazhdimësinë e këtij shërbimi, nëpërmjet shpronësimeve. Nëpërmjet punonjësve të Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane është realizuar shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave.

## **Ndriçimi i mjediseve publike**

Objektivat për këtë shërbim janë:

Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit

- a) Mirëmbajtje e ndriçuesve të zakonshëm ekzistues
- b) Mbajtja në efikasitet e ndriçimit të lulishteve ekzistuese.
- c) Mbajtja në efikasitet e ndriçimit rrugor
- d) Mirëmbajtja e gjithë rrjetit të ndriçimit rrugor.
- e) Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 12 Njësitë Administrative dhe ndërtimi i linjave të reja me prioritet zonat e populluara.

Ndërhyrjet rehabilituese janë realizuar nga Agjensite e Shërbimeve Publike përgjatë gjithë vitit pasi është siguruar me pare baza materiale e nevojshme dhe janë hartuar projektet. Janë realizuar një sërë projektesh nga të cilët përmëndim : “Blerje ndriçues, “lidhje te reja energjie”.

## **Politikat e zhvillimit**

1. Mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve, përmes bashkëpunimit me komunitetin e Bashkisë e shoqërinë civile. Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit, gjithpërfshirjes në fushën e mbrojtjes së natyrës në bashkëpunim me të gjitha institucionet rajonale dhe jo vetëm, për ndalimin e humbjes së biodiversitetit por edhe përmirësimit të statusit të tyre.
2. Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujrave sipërfaqësore, lumenjve dhe ujrave nëntokësorë, etj. Shfrytëzimin racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.
3. Zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullosore,

që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve pyjore, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimit dhe aftësisë ripërtëritëse të pyjeve, si dhe parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.

4. Realizimin e mbrojtjes së sipërfaqeve pyjore dhe kullimore nëpërmjet një qeverisjeje më të mirë të fondit për Administrimin e Pyjeve.
5. Hartim i projekteve teknike për pyllëzim të sipërfaqeve pyjore si dhe rehabilitim i sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni nëpërmjet investimeve për mbrojtjen e tokës.

#### iv. **Programi i Arsimit**

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmijë që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare.

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Elbasan duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucioneve arsimore për 12 njësitë administrative. Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet të fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan. Në kuadër të reformës së re administrative të qeverisjes vendore janë pjesë e këtij programi edhe delegimi i funksioneve të reja si: Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve, punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar, punonjësit e shërbimeve mbështetëse të arsimit të mesëm.

#### **Politikat e zhvillimit:**

1. Sigurimi i shërbimeve mbështetëse, cilësore në të gjithë territorin, për institucionet e edukimit parauniversitar dhe atij parashkollor gjatë procesit të realizimit të programit mësimor vjetor.
2. Mbështetja dhe promovimi i cilësisë së mësimdhënies dhe i rezultateve të larta në shkollë. Promovimi dhe nxitja e hapjes së strukturave të edukimit jashtë orarit mësimor, për të plotësuar një nga të drejtat bazë të fëmijëve, siç është argëtimi, loja, sporti etj
3. Përmirësimi i kushteve dhe standarteve të shkollave nëpërmjet ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, për

zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Elbasan.

4. Përmirësimi i shërbimit të ngrohjes me qëllim krijimin e kushteve për funksionimin dhe zhvillimin sa më normal të procesit mësimor.
5. Sigurimin e standarteve për sigurimin e higjenës për: konviktet, shkollat, kopështet, magazina, etj.
6. Përmirësimi i kushteve me anë të sigurimit të bazës materiale për shërbimet mbështetëse, me qëllim funksionimin sa më normal të objekteve shkollore (shkolla, kopështe, konvikte).

Rritja e sigurisë në ambjentet shkollore nëpërmjet shërbimit të rojeve të sigurisë publike dhe monitorimit me anë të sistemit të kamerave.

Përmirësimi i sistemeve të edukimit dhe trajnimit profesional dhe ndërlidhja e politikës arsimore me politikën social-ekonomike.

## F) Detyrime të prapambetura

Në zbatim të udhëzimit nr.35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për NJQV”, i ndryshuar, Bashkia ka raportuar në Ministrinë e Financave të dhëna për detyrimet e prapambetura, si më poshtë :

Detyrime të prapambetura

nr.	Emertimi	Stoku në vlerë	%
1	Vendime Gjyqesore	6,258	6%
2	Det.Prap.Sherbime	303	0%
3	Det.Prap.Mirembajtje	430	0%
4	Det. Prap.Investime	91,429	88%
5	Detyrime të tjera	5,426	5%
	<b>Totali</b>	<b>103,847</b>	<b>100%</b>

Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit gusht 2024 arriti në vlerën, **103,847 mijë lekë**, kryesisht në investime me vlerë **91,429 mijë lekë** ose **88%**, detyrime të tjera me vlerë **5,426 mijë lekë** ose **5%**, shpenzime për shërbime me vlerë **303 mijë lekë**, shpenzime për mirëmbajtje me vlerë **430 mijë lekë**, si dhe vendime gjyqësore me vlerë **6,258 mijë lekë** ose **6%**. Ky stok është parashikuar të shlyhet në Buxhetin e vitit 2024.